

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË**  
**KUFIZUAR**  
**GLEANTI SH.P.K.**

Sot, ne Tropojë, me **14.06.2024**, unë Ortaku **Eduart Isuf Pepnika** me numër identifikimi ID **I30731019N**, hartoj **Aktin e Themelimit** te shoqërisë **GLEANTI Sh.p.k.**, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijnë:

**Neni 1**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë zhvillimit të veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që do t'i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

**Neni 2**

Emërtimi i shoqërisë është **GLEANTI Sh.p.k.**

**Neni 3**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Fshati Dojan, Njesia Administrative Bujan, Tropoje.**

Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e **ortakut të vetëm/asamblesë së ortakëve**, i cili zoteron **100 %** te kapitalit themeltar ne momentin e krijimit te kesaj shoqerie.

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Mbledhja, prodhimi, perpunimi, tregtimi dhe shitja e frutave të pyllit, bimeve mjeksore dhe produkteve dhe sherbimeve te tjera agroushqimore që lidhen me to, duke përfshirë eksportin dhe importin e ketyre produkteve dhe të gjitha aktivitetet teknike dhe operacionet financiare të lidhura ose plotësuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi me aktivitetet e sipërpermendura. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të fitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi interesa në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje.

Transport mallrash dhe pasagjeresh.

Makina me qera, transport me automjete dhe me shofere, asistence profesionale per organizimin dhe zhvillimin e aktiviteve te tjera ne fushen e biznesit, kultures, sportit etj.

Tregtim dhe shitje me shumice dhe pakice i produkteve ushqimore, pijeve dhe duhan, pajisjeve industriale, elektrike, telefonike, kancelari, detergjentë dhe mjete te tjera pastrimi etj.

Te kryej cdo transakcion ne lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe te luajtshme si dhe cdo aktivitet tregtar financiar, të jap dhe te marre me qira. Shoqeria mund te zhvilloje cfaredo lloj aktiviteti tjetër te afert ose qe lidhet me objektin



e saj, e vetme ose me pjesmarrje me ente, ndermarje apo shoqeri te tjera, duke kryer te gjitha operacionet financiare te nevojshme per arritjen e qellimit te Shoqerise.

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe **te pakufizuar kohe**.

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Leke** i ndarë në **1 kuote** e e cila zotërohet nga **ortaket themelues si me poshte :**

**1. Eduart Pepnika** në masën **100%** te kuotave.

Te gjithë pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen, do te shlyhen plotesisht nga **Ortaku i vetëm**.

Shuma e depozituar do te vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga Banka ku eshte bere depozitimi, ne te cilin shenohet emri dhe mbiemri **i ortakëve, pjesa e kapitalit themeltar** të nënshkruar **dhe te derdhura prej tij**.

**Ortaku i vetem** kane te drejte te beje zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit sipas vendimit qe merr vete ai.

#### **Neni 7**

Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria tregtare **Gleanti Sh.p.k.** përfaqësohet nga Administratori i Shoqërisë, i emëruar **Z. Eduart Pepnika**.

#### **Neni 8**

Cdo gjë që do të kryhet parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e te cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 9**

Ky Akt Themelimi është hartuar në Tropojë, me datë **14.06.2024**.

**ORTAKU I VETEM**

**EDUART PEPNIKA**

